



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

KRYETARI

V E N D I M

Nr. 1041 datë 09.01 2018

P Ë R

PLANIN VJETOR PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË SHËRBIMIN CIVIL

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si dhe Urdhërit të Kryetarit nr.34333, datë 18.09.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Institucionit të Bashkisë së Tiranës”, si rezultat i krijimit të vendeve vakante;

VENDOSA:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2018 në Bashkinë Tiranë, pjesë e shërbimit civil, është gjithësej 261, i ndarë sipas kategorive të mëposhtme:
 - 8 (Tetë) nëpunës civil, të Nivelit të Mesëm Drejtues;
 - 30 (Tridhjetë) nëpunës civil, të Nivelit të Ulët Drejtues;
 - 223 (Dyqindnjëzetëtre) nëpunës civil, të Kategorisë Egzekutive;
2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë:
 - Shkenca juridike;
 - Shkenca kompjuterike;
 - Shkenca ekonomike;
 - Shkenca ekonomike/juridike;
 - Shkenca shoqërore;
 - Shkenca sociale;
 - Agronomi;

- Shkenca mjedisore ose te tjera te pershtatshme;
 - Shkenca inxhinierike;
 - Arkitekturë;
 - Gjeodezi;
 - Arsim i lartë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

